



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë .11.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Dekore per festa ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

(Dekorime) **45451000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,583,333 (katër milion e pesëqind e tetëdhjet e tre mijë e  
treqind e tridhjet e tre) lekë PA TVSH.**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e parashikuar e kontrates**.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne: *nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatimtëLigjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,datë 30.01.2006,"Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar,VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formes elektronike",si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

### 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Termet e referencës, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 1453 Prot., date 02.11.2023.**

**Ato janë si më poshtë:**

Specifikimi i Materialeve:

Nr	Emertimet	Njesia	Sasia
1	Instalacion metalik në formë 4 (kater) I ndertuar me profil hekuri	cope	1
2	Instalacion metalik në formë tuneli	cope	1
3	Bazament metalik në formë konike	cope	1
4	Instalacion metalik në formë piramide	cope	1
5	Struktura druri me personazhe (Grazhd për Krishtlindje)	cope	1
6	Gardh prej druri tetekendor	cope	2
7	Globa dekorative për brendësi me dimensione $\phi$ 20 cm	cope	150
8	Globa dekorative për brendësi me dimensione $\phi$ 15 cm	cope	500
9	Globa dekorative për brendësi me dimensione $\phi$ 10 cm	cope	500

## Specifikime

## **1. Instalacion Metalik ne forme 4 (kater) i ndertuar me profile hekuri**

- Profil hekuri i perdorur 25x25x2mm
- I lyer me antiruxho dhe boje. Ngjyra e zeze
- Struktura tredimensionale me tre ndarje terthore
- Dimensione: Lartesi 4 meter, gjeresi 3 meter dhe thellesi 1 meter
- Struktura e veshur me shirita dekorative LED, me mundesi bashkimi me mufta hermetike. Largesia e dritave nga profili 7cm. Ngjyra e ndricuesve 4000K. Ngjyra e kabllit e gjelber. Standarti IP44
- Perimetri i struktures i veshur me ndricim fotosuline dekorative 4000K. Trashesia e tubit 13mm. Largesia midis llampave 2.77cm. Tubi te kete tre fije teli brenda qe lidh llampat. Mundesia e prerjes te tubit, cdo 1 meter. Mbrojtja nga uji IP67

## **2. Instalacion metalik ne forme tuneli 10 meter gjatesi dhe me seksione te montueshme**

- Profil hekuri i perdorur: Perimetri 50x30x2mm, seksionet e brendshme 30x30x2mm
- I ndare ne 3 seksione 3.36 meter secila, te montueshme me vida
- Cdo seksion te kete 6 ndarje me profile 30x30x2mm
- I lyer me antiruxho dhe boje. Ngjyra e zeze
- Dimesione: Gjatesi 10 meter, Lartesi 3.2 meter dhe gjeresi 3.5 meter
- Struktura e veshur me shirita dekorative LED, me mundesi bashkimi me mufta hermetike. Ngjyra e ndricuesve 4000K. Ngjyra e kabllit e gjelber. Standarti IP44
- Struktura e montuar ne toke me prixhoniere

## **3. Bazament metalik ne forme konike me baze me diameter 6 meter kulmi 4 meter**

- Bazamenti metalik me profile 40 x 40 x 3 mm
- Diametri i bazes 4.5 meter. Diametri i kulmit 3.8 meter
- I perforcuar ne 8 seksione qe lidhin bazen me kulmi
- Ne qender te kulmit te vendoset nje tubo Ø120 mm e perforcuar me kryqe
- Struktura e lyer me antiruxho dhe boje ngjyre jeshile
- Struktura e montuar ne rrethrotullim me prixhoniere

## **4. Instalacion ne forme piramide**

- Instalacion metalik ne forme piramide trekendore, ndertuar me profile hekuri 30 mmX 30 mm x 2 mm
- E lyer me antiruxho dhe boje vaji ngjyre te zeze
- Dimensione: lartesi 600 cm dhe baze 300 cm x 300 cm x 300 cm

- Struktura duhet te jete e veshur ne te gjithe perimetrin me fotosuline led 4000 kelvin, 36 led/meter, largesia midis llampave 2.77cm, trashesia e tubit 13mm, mbrojtja nga uji IP67, mbrojtje UV, 230V AC 4.3W/m (RED: 3.8W/m), mundesia e prerjes te tubit, cdo 1 meter.
- Struktura duhet te jete e mbushur me shirite ndricues me drita led cdo 15 cm te strukures metalike. Shiritat led me ndricim 4000 kelvin, me llampa Led Flash, llampat led me kapucmbrojtjes cdo 5 cm, standarti IP44, 220-240V AC / 31V DC (12W) 5.6W , verifikimi i cilesise CE-GS, CE-GS TUV, RoHS me mundesi bashkimi me mufta hermetike.

##### 5. Struktura druri me personazhe (Grazhd per Krishtlindje)

- Shtepi druri me çati me kulm
  - Dimensione: 500 x 300 x 260 cm
  - Catia e izoluar me kartosere
  - Traret kryesore me 100 x 100 cm
  - Muret perimetrare me derrasa 200 x 2.2 mm
  - Gardhi rrethues me drure rrumbullake ahu natyrale Ø 6 mm
  - Modulet e drurit te lyera me llak mbrojtjes nga uji
  - E gjithe struktura me mundesi cmontimi me vida
  - Grazhdi te permbaje 9 statuja te ndryshme tredimensionale, njerez dhe kashe. Njerezit me lartesi 160cm dhe kafshet me lartesi 60 cm.
  - Te gjitha statujat te jene material FIBER XHAM
- Foto ilustruese (Thjesht per ide )**



## **6. Gardh prej druri tetekendor**

- Diametri i jashtem 10 meter
- Lartesia 80cm
- Secili element 100 x 20 mm me maje, i lidhur me kadrona 50 x 30 ne pjesen e brendshme, i montuar me vida
- Te jete i perbere nga 8 seksione, secili 380 cm i gjate. Secili seksion i lidhur ne kulme me kadrona 80 x 80 mm me baze metalike
- I lyer me llak te erret kunder ujit

**Zeri 7.** . Globa dekorative per bredh me dimesnione Ø 20 cm Ngjyra Gold

**Zeri 8.** Globa dekorative per bredh me dimesnione Ø 15 cm Ngjyra Gold dhe e Kuqe

**Zeri 9.** Globa dekorative per bredh me dimesnione Ø 10 cm Ngjyra Gold dhe e Kuqe

**Specifikimet teknike jane hartuar pas verifikimeve te kryera ne lidhje me nevojat qe ka qyteti per dekore per festat e fundvitit.**

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi :

**Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me dekore te ndryshme per festat e fundvitit.**

**Kontraktuesi duhet te furnizojë me mallra ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri ne dorezimin ne vendin e percaktuar qe eshte magazina e ndermarrjes se Sherbimeve publike, Bashkia Korçe.**

**Afati : 10 dite nga data e lidhjes se kontrates.**

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet jane kerkuar sipas sasive dhe nevojave efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit. Materialet jane specifikuar ne menyre te tille qe te jene te pershtatshme per te qene sa me rezistente dhe te dukshme ne rruge, gjithashtu qe do te permbushhin te gjitha standartet.

➤ *Personi përgjegjës për specifikimet dhe llogaritjen e fondit limit*

**Përgjegjës në sektorin e eventeve**